

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljetë Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. I nga fsh. L i E, K Gj, për shkak të veprës penale **Vjedhja e Shërbimeve Komunale**, nga neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, PP. II. nr.1680/2015, të datës 07.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 25.07.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 27.07.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. I nga babai B dhe nëna N, e lindur M, i lindur më datë., në fsh. ku edhe jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, pensionist, ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar deri më tani, dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, prej datës së pavërtetuar, e deri më dt. 11.03.2015, në shtëpinë e tij, në fsh., K. e Gj, me qëllim që vetes t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, (ekipi i kontrollit), është vërejtur se njehsori elektrik ka qenë i pablombuar dhe pasi kanë hapur panelin kyqës të njehsorit, kanë vërejtur se i akuzuari kishte larguar tri urat e tensionit duke e dëmtuar në vlerë prej 46.57 €,

-me çka ka kryer vepër penale **Vjedhja e Shërbimeve Komunale**, nga neni 320, të KPRK-së, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Të akuzuarin S. I., me **Dënim me Kusht, Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh dhe Dënim Gjobe, në shumëm prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €**, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë

I akuzuari lirohet nga pagesa e paushallit gjyqësor, për shkak të gjendjes së vështirë materiale, ndërsa, shpenzimet bien në barrë të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 1680/2015, të datës 07.10.2015, kundër të akuzuarit S. I, për shkak të veprës penale, Vjedhja e Shërbimeve Komunale, nga neni 320 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurori Ismet Ukshini, në fund të procedurës deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit S. I.nuk është kontestues se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritator sipas ligjit, ndërsa, përkritazi me lartësinë dhe llojin e dënimit, gjykata t'i ketë parasysht rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, e më pastaj, të akuzuarit t'ia shqiptojë sanksionin adekuat penal, në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit dhe kjo të jetë preventivë për të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryejë vepra të ngjashme.

Përfaqësuesja e autorizuar e KEDS-it, Distrikti në Gjilan, ..., deklaroi se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjiten ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe kërkojnë kompensim material nga i njëjti.

I akuzuari, në fund të procedurës deklaroi se i vjen keq për veprën e kryer penale, është penduar për këtë, këtë e ka bërë për shkak të kushteve të rënda ekonomike, premtori se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, andaj, kërkon nga gjykata t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari e ka kryer veprën penale **Vjedhja e Shërbimeve Komunale** nga **neni 320** të KPRK-së.*

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tij, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1019/15, më datë 27.07.2017

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.